

# EDUKIMI SIGURON



# TË ARDHMEN

## JEMI TË BARABARTË

BLERONA (14), RINORA (13), BERTA (14), KLODINA (14), ARIANA (14), ARBENI (14), JETMIR (14)



### Demokracia është ...


Në Kosovë të gjithë qytetarët e kanë të drejtën e votës, sepse Kosova është shtet demokratik. Falë këtyre lirive dhe të drejtave që i kemi në mesin tonë, ne mund t'i shprehim lirshëm mendimet dhe dëshirat tona. Shumë kohë më parë, filloi të zbatohet demokracia. Më saktësisht, për herë të parë ajo filloi të zbatohet në vitin 507 para erës sonë në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Vetë fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Ekzistojnë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemin parlamentar (populli zgjedh me anë të votave deputetët, pastaj ata zgjedhin Presidentin) dhe sistemin presidencial, ku është populli ai i cili, po ashtu, zgjedh Presidentin e vendit me anë të votave. Demokracia është për të gjithë, jo vetëm për një per-



Ligjet duhet t'i respektojmë

son apo për një grup personash. Prandaj, duhet të jemi sa më të bashkuar dhe të punojmë për të adhmen e vendit tonë.

Çdo vendim dhe çdo veprim yni ndikon në jetën tonë. Andaj, nëse dëshirojmë të kemi një ardhmëri sa më të mirë dhe të ndritur, duhet të mësojmë dhe të kemi sa më shumë respekt për njëri-tjetrin.



E drejta e votës në demokraci



Gazetarët e artikullit

# KONTRIBUTI PËR VENDIN TONË

ERJON (14), MUSTAFË (15), GRESA (15), ADEA (14), ALTINA (14), RINOR (15), GENTIANA (14)

**Të nderuar qytetarë e të dashur lexues, iu ftojme ta lexoni artikullin tonë. Ne kemi dhënë disa mendime se si ne mund të kontribuojmë në vendin tonë**

Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe të mbrojtur nga ligji, pa marrë parasysh moshën, fenë, gjininë, kombësinë apo racën. Çdo qytetar ka të drejtat dhe liritë e tij të barabarta me qytetarin tjetër.


Qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme. Ata kanë të drejtë të bëjnë organizim për pastrimin e një vendi, të bëjnë punë vullnetare, t'iu ndihmojnë të tjerëve, etj. Nëse ne i jetësojmë këto të drejta, atëherë ne jemi qytetarë aktiv. Prandaj, të jesh aktiv është shumë e rëndësishme për shtetin. Për shembull, një kryetar i një komune mund të bëjë tubim publik. Këto tubime publike organizohen për të biseduar me qytetarët, apo edhe për të dëgjuar për problemet ose hallet e tyre, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e atyre problemeve. Qytetarët aktiv, në këtë rast, marrin pjesë në tubime të tilla publike.

Më lart treguam se qytetarët kanë të drejta, por përveç të drejtave, ata kanë edhe përgjegjësi. E drejtë e tyre është të marrin pjesë në zgjedhje, por përgjegjësia e tyre është të votojnë.

Nëse ne dëshirojmë që vendi ynë, të jetë sa më i zhvilluar, duhet të kontribuojmë si qytetarë aktiv. Kontributi më i madh i së ardhmes tonë është tani, sepse ne jemi e ardhmja e vendit tonë.



Grupi „Legjendat“



Qytetarët aktiv mendojnë edhe për hapësirat publike




Të ndihmohet të tjerët dhe të jesh i respektueshëm është shumë e rëndësishme



Në demokraci, vendimmarrja i takon popullit duke votuar përfaqësuesit e vendit


## JEMI TË LIRË TË ZGJEDHIM

BLENDINA (14), FESTIM (14), EGZONA (14), LEORESA (14), DIONIS (14), RINOR (14), ENIS (14),  
ERZA (15)



**Në këtë artikull të shkruar nga grupi ynë, mund të mësoni më shumë rreth procesit zgjedhor dhe rreth rëndësisë që ka ky proces**

Motra ime e madhe këtë vit ka votuar për herë të parë. Ajo edhe më herët gjatë përditshmërisë ka votuar në



**Të votosh do të thotë të përdorësh të drejtën tënde**

shkollë, në shtëpi, por edhe gjatë ndonjë aktiviteti. Megjithatë, kësaj here ishte pjesëmarrja e saj e parë në procesin zgjedhor. Meqë ka arritur moshën 18 vjeçare, ajo si qytetare aktive që është, ka shfrytëzuar të drejtën e saj për votim.

Unë isha shumë kurioze të dija pse është kaq e lumtur. Andaj, edhe e pyeta: „Pse je kaq e gëzuar që do të votosh?“. Ajo u përgjigj: „Të votosh do të thotë të jesh pjesë e vendimmarrjes në shtetin tënd. Vota ime bën ndryshim në vendin tim. E si të mos jem e lumtur?“. Pas kësaj përgjigje, mendova dhe u binda se vër-

tet vota ka vlerë të madhe. Të votosh do të thotë të brengosesh për vendin tënd. Të votosh do të thotë të jesh i/e lirë të zgjedhësh udhëheqësit e tu. Të votosh do të thotë të ndryshosh jetën tënde dhe të qytetarëve të tjerë. E shihni, pra, sa e rëndësishme është vota jonë? Andaj, gjithmonë duhet të jemi pjesëmarrës në procesin më demokratik, e që është procesi zgjedhor. Ne qytetarët e Kosovës votojmë në dy lloj zgjedhjesh. Votojmë në zgjedhjet komunale, ku zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët e atyre komunave. Gjithashtu, kemi zgjedhjet qendrore, ku ne si qytetarë i zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët njihen si deputetë dhe të cilët punojnë në Kuvend. Me kaq nuk përfundon artikulli ynë. Ne iu ftojmë të lexoni edhe faqen tjetër dhe të shihni se çka kemi përgatitur aty për ju.



**Gazetarë me vlera demokratike**



Demokracia na jep shumë të drejta të gjithë neve si qytetarë. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë pa dallime. Mirëpo, një e drejtë shumë e rëndësishme është e drejta e votës



Ne po ashtu, duke qenë qytetarë të një shteti demokratik, gëzojmë të drejtën e shkollimit dhe të drejtën për të zgjedhur profesionin e dëshiruar. Askush nuk mund ta ndaloj edukimin tonë

**Në këtë artikull, të punuar gjithashtu nga grupi ynë, do të mund të informoheni më shumë për partitë politike**

Dikujt nga ne i pëlqen pianoja, dikujt futbollit e dikujt tjetër vallëzimi. Të gjithë ne ndjekim kurse të ndryshme të fushave që më së shumti na interesojnë. Në të njëjtën mënyrë funksionojnë edhe partitë politike. Partia politike paraqet një grup të bashkëmendimtarëve, qëllimi i të cilëve është realizimi i programit të përbashkët. Ato janë lidhje e lirë e bashkëmendimtarëve, të cilët krijojnë propozimet programore për zgjidhjen e problemeve dhe kandidojnë anëtarët e saj për udhëheqjen e shtetit. Ne si qytetarë jemi të lirë të vendosim se cilës parti duam t'i takojmë dhe cilën parti duam ta votojmë.



Festimi gjatë punës në grup





Ne të gjithë jemi të lirë të votojmë për partinë që na pëlqen. Jemi të lirë që gjithashtu të jemi pjesë e cilësdo parti që na pëlqen

## DEMOKRACIA PARLAMENTARE (PËRFAQËSUESE)

ERJON (14), RIAD (14), LAURA (14), ALTIN (14), FLORENT (14), ABAZ (14), ALMIRA (14), LORESA (14),

AGNESA (14)



Këtu kemi paraqitur një shok imagjinar, emri i të cilit është Taulant. Në vizatimin e parë, kemi paraqitur Taulantin duke menduar për kandidatët e mundshëm për deputetë. Ndërsa, në vizatimin e dytë Taulanti veçse është duke votuar për atë kandidat që ai mendon se do t'i plotësojë nevojat e tij. Taulanti e don më të mirën për vendin e tij, andaj ai voton

**Të dashur lexues, në artikullin e shokëve e shoqeve tona keni mësuar më shumë rreth demokracisë dhe rëndësisë së saj. Po ashtu, keni mësuar edhe për zgjedhjet dhe llojet e tyre në Kosovë. Në artikujt tanë do të informoheni më shumë për deputetët dhe Kuvendin**

Ne të gjithë e dijmë që anë e kënd botës, demokracia është një ndër konceptet që përdoret më së shpeshti. Arsyeja pse mendojmë kështu është sepse për këtë fjalë kaq të ëmbël, ne mësojmë pothuajse çdo ditë. Mësojmë nga jeta e përditshme. Apo më saktë nga rutina jonë si nxënës e si qytetarë, por po ashtu edhe në shkollë. Nuk kalon asnjë ditë e vetme që ne nuk i përmendim elementet e demokracisë. E gjithmonë, si për çudi, ndalemi tek e drejta e zgjedhjes dhe e drejta e fjalës së lirë. Sipas grupit tonë, këto dy të drejta janë baza e një demokracie të mirëfilltë dhe kushte për funksionimin e drejtë të shtetit. Kjo sepse kur qytetarët gëzojnë të drejtën e fjalës së lirë dhe të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, na lë të kuptojmë se janë qytetarët, ata të cilët vendosin për të ardhmen e tyre. Përmes zgjedhjeve, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin vendime për të mirën e të gjithëve. Këta të fundit, kanë të drejtë t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, qoftë në nivelin lokal, qoftë në atë qendror. Deputetët, e zgjedhur në zgjedhjet qendrore, kanë mandat 4 vjeçar dhe janë në shërbim të popullit

gjatë këtyre viteve. Çdo qytetar përpara se të vendos për kandidatin për deputet/deputete duhet të mendoj shumë gjatë, sepse janë deputetët, ata të cilët do të marrin vendime për qytetarët. Një shembull konkret të kësaj mund ta ndajmë me ju.

Muaj më parë, pak kohë para zgjedhjeve qendrore unë diskutova me babain tim rreth rëndësisë së deputetëve. Ai më tha që këtë vit, do ta votojë për deputet të njëjtin person, të cilin e kishte votuar 4 vjet më parë. Mund të pyesni pse? Sipas tij: "Ai deputet gjatë mandatit të parë i kishte përmbushur pothuajse të gjitha premtimet që i kishte bërë. Një ndër premtimet ishte përmirësimi i rrugëve të lagjes sonë, si dhe kishte premtuar që në mandatin tjetër do t'i realizonte premtimet e tjera. Kjo është një arsye e fortë për ta votuar prapë atë," përfundoi babai im.



Sot kishim rolin e gazetarëve dhe të deputetëve

Por, babai im më tha që një gjë duhet ta kuptoj mirë: „Për të qenë deputet dhe për t'i shërbyer popullit është një ndër privilegjet më të mëdhaja që një person mund t'i posedoj. Por, njëkohësisht kërkon edhe shumë përgjegjësi,“ më tha „sepse nga deputetët varen shumë ëndërra që qytetarët i thurin për vendin dhe të ardhmen e tyre. Qytetarët nga dita kur votojnë, tërë fuqinë që kanë e bartin tek kandidatët për deputetë dhe shpresat që vendi do të udhëhiqet në mënyrën më të mirë të mundshme, veç sa fillojnë e rriten.“ Për këtë të jesh deputet është përgjegjësi, aq sa është edhe privilegj. Kandidatët që dalin fitues në zgjedhje e bëjnë edhe betimin e deputetit. Betimin për ju e ka shkruajtur shoqja Laura. Lexojeni.

*Betimi i Deputetëve*

*"Unë, deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, besojmë se me ndërkombëtarë do ta kërkojmë detyrën dhe do ta përfundojmë me detyrën popullin do të punojmë në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mirënjohjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të drejtave të njerëzve, për mirënjohjen e tërësive demokracisë dhe të integritetit institucionel të Kosovës, për garantimin e lirisë dhe të drejtave të njerëzve në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Berohen!"*




**Në vijim të artikullit do të mësoni për vendin ku punojnë deputetët e që është Kuvendi i Kosovës**

Kuvendi i Kosovës është një ndër institucionet më demokratike në vendin tonë. Kjo sepse qytetarët të cilët punojnë aty janë deputetët, të cilët ne të gjithë i njohim si përfaqësues të popullit. Kuvendi është institucion, në të cilin kuvendojnë 120 deputetë. Të gjithë mundohen dhe punojnë për të mirën e popullit. Mënyrën se si zgjedhen këta deputetë e kemi cekur në artikullin paraprak. Por, çka vlen të theksohet është se shumica e deputetëve, ani pse iu përkasin partive të ndryshme politike, prapëseprapë fillimisht kanë për detyrë t'i përfaqësojnë nevojat e qytetarëve e pastaj të partisë së tyre. Për partitë politike besojmë që keni marrë informata nga artikulli në faqen 5.



**Ne e dijmë që ende nuk e gëzojmë të drejtën për të kandiduar për deputetë, por vetëm patëm dëshirë të përjetojmë se sa përgjegjësi është kandidimi për deputetë**

Në këto vizatime kemi paraqitur disa fakte për Kuvendin, siç janë: pjesëmarrja e grave në Kuvendin e Kosovës dhe funksionet e Kuvendit: funksioni Legjislativ, Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor. Dhe në fund kemi paraqitur Kushtetutën, nga e cila rrjedhin të gjitha këto që i cekëm



**Jeta jonë do të ishte shumë më ndryshe, nëse nuk do të ekzistonte Kuvendi**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Hilmi Rakovica“  
Klasa: IX-5  
Vendi: Prishtinë